



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1565/9 prot.

Datë 02.07.2024

V E N D I M
Nr. 787/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.07.2024, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. protokolli 1565/2024 datë 12.06.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-01414-04-15-2024, me objekt: “*Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike*”, me fond limit 62,409,264 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 16.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK, me NIPT (K26330202E), me adresë: Lagja “Uji i Ftohtë”, në perëndim të Rrugës Vlorë – Oriqum, në kufi me Rezidencën Qeveritare, Vlorë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë, me adresë: Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 16.04.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-01414-04-15-2024, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, me fond limit 62,409,264 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 16.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

II.2. Në datën 12.06.2024, është dorëzuar ankesa nr. protokoli 1565/2024 datë 12.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rafin Company” SHPK.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1565/2, datë 13.06.2024, lidhur me kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Rafin Company” SHPK.

II.4. Në datën 20.06.2024, protokolluar me tonën me nr.1565/3, operatori ekonomikë “Rafin Company” SHPK ka paraqitur pranë KPP-së Formularin e Paraqitjes së Argumentave, si operator ekonomik i interesuar.

II.5. Me anë të shkresës nr.2643 prot., datë 19.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1565/4 prot., datë 21.06.2024, autoriteti kontraktor na vë në dijeni për shtyrjen e afatit të shqyrtimit të ankesës së bashkimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Me anë të shkresës nr.2561/4 prot., datë 28.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1565/6 prot., datë 01.07.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.7. Me anë të shkresës së, protokolluar me tonën me nr. 1565/5 prot., datë 01.07.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK, njofton se *“BOE Valona Konstruksion shpk dhe Zeqillari shpk tërhiqet nga ankesa për shkak se shoqëria Valona Konstruksion shpk si lider i këtij bashkimi me 88 %, është kualifikuar në një procedurë tjetër prokurimi dhe pamundësisë së realizimit të kësaj kontrate në kohë me stafin që disponojmë sipas grafikut tërhiqemi nga kjo procedurë prokurimi, rrjedhimisht edhe nga kjo ankesë.”*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-01414-04-15-2024, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, me fond limit 62,409,264 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 16.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankesë dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër nr. Protokolli 1565/2024, datë 12.06.2024, të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-01414-04-15-2024, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, me fond limit 62,409,264 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 16.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Valona Konstruksion” SHPK & “Zeqillari” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

